

## De Biasi drejt largimit

nga Albaniassocer

E martë, 28 Qershor 2016 12:28

---



Gianni De Biasi mund të largohet nga drejtimi i kombetares shqiptare. Ne orët e fundit flitet për një interesim të kombetares angleze në drejtim të italianit të pankines kuqezit. Pas eliminimit të anglezeve nga ana e Islandes në European trajneri Roy Hodgson dha dorëheqjen nga drejtimi i kombetares mbretërore. Që në orët e para të mëngjesit filluan të qarkullonin zërat për një interesim të federates angleze për trajnerin e Shqipërisë. I pyetur nga gazetaret për këtë eventualitet De Biasi u përgjigj që do të ishte i nderur të drejtonte një kombetares të tilla. Nëse do të ndodhe do të ulem të diskutojmë me drejtuesit e federates angleze. Tani mbetet të presim zhvillimet me të fundit për sa i përket trajnerit kuqezit.